



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

KULTIVIMI I SPECIT NË FUSHË TË HAPUR

Te nderuar fermer,

Jemi ne periudhën e mbjelljeve pranverore për kulturat e ndryshme perimore, andaj qe te jeni te suksesshëm shfrytëzoni afatet optimale për kultivimin e specit ne fushe te hapur.

Speci është bima kryesore perimore në Kosovë si për nga sipërfaqet ashtu edhe për nga rëndësia ekonomike. Forma dominuese e kultivimit të specit është kultivimi në fushë të hapur. Përmes këtij mesazhi ju japim disa informata te rëndësishme për një prodhimtari te suksesshme te specit ne fushë te hapur.

Kërkesat ndaj kushteve klimatike

Temperatura, drita dhe uji janë faktorë kryesorë, dhe nëse këta faktorë janë në favor dhe në sasi çfarë i kërkojnë perimet në përgjithësi dhe speci në veçanti rendimenti nuk do të mungojë, nëse kësaj i kanë parapri edhe të gjitha masat tjera agroteknike siç janë: Lëvrime më kohë dhe cilësorë përdorimi i plehrave në sasi të nevojshme, ujitja cilësore të formës pikë-pikë për objektet e mbrojtura dhe në formë shiu për specin e kultivuar në sipërfaqe të hapura.

Nxehtësia

Në bazë të hulumtimeve të shumta është vërtetuar se temperaturat optimale për rritjen dhe zhvillimin e bimës së specit sillen në kufijtë $25 \pm 5 - 70^{\circ}\text{C}$. Fara fillon të mbijë në 13°C , ndërkaq temperatura optimale për mbirje është 25°C . Temperaturat e ulëta nën 15°C , sidomos nëse ato shoqërohen me mungesë të dritës, mund të sjellin deri tek rënia e luleve.

Drita

Speci është bimë tipike me kërkesa të mëdha për dritë (heliofite), duke filluar nga fazat e hershme të rritjes së bimëve. Në kushte të mungesës së dritës bimët e specit zgjaten, etiolizohen dhe lulet dhe frutat e porsaformuara bien.

Lagështia

Kërkesat e specit për lagështi janë mjaft të theksuara në të gjitha fazat e rritjes dhe zhvillimit të bimëve. Deri në kohën e frutifikimit, lagështia në tokë është e preferuar që të jetë afër 70% të kapacitetit fushor uJOR, ndërsa në kohën e frutifikimit 80%. Pra rritje me të hovshme të masës mbitokësore (kërçelli, gjethe dhe frutat) te speci kemi kur lagështia e tokës mbahet në nivelin e 70-80 % të kapacitetit uJOR tokësor dhe lagështia e ajrit sillet prej 60-80%.

Plehërimi

Nga plehrat organik rëndom përdoret plehu i stallës dhe atë në sasi 30 – 50 t/ha.

Sasitë orientuese të lëndëve ushqyese, në formë të materieve aktive, për rendimentin e planifikuar prej 35 – 40 t/ha, do të ishin: 130 – 150 kg N/ha, 80 – 100 kg P₂O₅/ha dhe 150 – 250 kg K₂O/ha. Afatet e dhënies së plehrave mineral, duhet të adaptohen mënyrës së prodhimit, kultivarit dhe qëllimit të prodhimit.

Ndërrimi i fidanëve në fushë

Përgatitja e mirë e tokës është parakusht i rëndësishëm në prodhimin e suksesshëm të specit. Toka duhet të përgatitet në atë mënyrë që të krijohet në të një regjim optimal uJORë-ajror.

Për ndërrim fidanët duhet të kenë së paku 5– 6 gjethe, të jenë të shëndoshë dhe të kalitur mirë. Është e preferuar që fidanët të ndërrohen së bashku me dheun-substratin në të cilin ndodhet fidani.

Ujitja me pika përfaqëson mënyrën më të përshtatshme të ujitjes së bimëve. Nëpërmjet ujitjes me pika prodhuesi ka mundësi të kontrollojë me saktësi dozat e ujit dhe të plehrave që u duhen dhënë bimëve. Për pasojë, rritet mundësia për të realizuar prodhime të larta dhe me cilësi më të mirë. Andaj në prodhimin intensiv të specit është e preferuar që çdo herë të përdoret ujitja pikë-pikë.

Kush mund ofroj informata shtese për nevojat tuaja?

Për këshilla dhe informata tjera te detajuara ju njoftojmë qe mund te drejtoheni ne Qendrat Informative Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, secili ne komunën e vet tek këshilltarët komunal për këshilla bujqësore. Aty do te merrni edhe sugjerime ne bazë te kushteve klimatike tokësore qe keni ne parcelat tuaj. Te dhënat në mesazh janë orientuese.

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. “Ukshin Hoti”, ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova

Tel. 383- (0)3820038426